



Republika e Kosovës * Republic of Kosova

Komuna * Municipality

Hani i Elezit



DATE: 25.06.2024

NR.09/ 5865/2024

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-24-5671-1-4-7/C534& KKHE(VM) 24-024-147

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Goni Computers SH.P.K., Rr. "Agim Matoshi" pn., Ferizaj, me NUL.811387001 (në vazhdim "Furnizuesi"), përfaqësuar në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

"Furnizim dhe servisim të kamerave në AMF-Gorancë KKHE(VM) 24-024-1-4-7" me numër identifikues: 659-24-5671-1-4-7 Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	"Furnizim dhe servisim të kamerave në AMF-Gorancë KKHE(VM) 24-024-1-4-7"

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Kohëzgjatja e kontratës është prej 30 diteve nga koha e nënshkrimit të saj

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 915.00 € [Nëntëqind e pesmbdhjetë Euro zero zero centi] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

☐ N/A

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: ☐ N/A

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues **KOMUNA HANI I ELEZIT**

Emri:	Avdush BAJRAMALIU
Pozita:	Zyrtar i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	25.06.2024
Vula:	



Për Furnizuesin **Goni Computers SH.P.K.**

Emri:	Agron AJVAZI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	25.06.2024
Vula:	



³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-5671-1-4-7

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Ferizaj-dega në Kaçanik.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe .
Programi i ekzekutimit	11	[Kohëzgjatja e kontratës është prej 30 diteve nga koha e nënshkrimit të saj]
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	[Te gjitha taksat dhe tatimet mbulohen nga OE-deri në dorëzimin e furnizimit tek AK-ja]
Patentat dhe licencat	13.1	[Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë]
Cilësia e furnizimeve	18.2	[shëno nëse pranimi paraprak teknik është i nevojshëm]
Inspektimi dhe testimi	19.2	AK- do të kontrollojë cilësinë dhe sasinë e furnizimit në kohën e pranimi të tij dhe me pas furnizimi do të pranohet nëse është konform kësaj kontrate] Per ecurin dhe realizimin e kësaj kontrate kujdeset Drejtoria e Shëndetsis dhe Mireqenjes Sociale
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet pas pranimi të furnizimit në cilësi dhe sasi ashtu siq ka përcaktuar AK-ja [Pagesa do të bëhet brenda afati ligjor]
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit - Komuna e Hanit të Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - Divizioni i rregullave]
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [[Gjykata Themelore në Ferizaj dega në Kaçanik] në pajtim me ligjin në Kosovë. Ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].